

Të dhëna relevante për vendin

- Humbjet dhe derdhjet të një forme ose tjetre (ujë i pashfrytëzuar) janë më shumë se 60% të ujit që shfrytëzohet prej shërbimeve komunale. Kjo është vlerë e madhe (30% është një referencë e arsyeshme e BE-së).
- 7 prej 17 ndërmarrjeve të analizuara komunale (NPK) në Projektin për reforma në sektorin e ujërave në nivel qendror, nuk i masin rregullisht dhe në mënyrë të standardizuar humbjet e ujit. Vetëm një NPK ka ujë të humbur (të pashfrytëzuar) nën 30%, 4 NPK ndërmjet 31 – 50% dhe në plotësim 4 NPK ndërmjet 51 – 70%. Pothuajse asnjë nga 17 NPK të analizuara nuk i kompensojnë tërësisht harxhimet për sigurimin e shërbimeve ujore. Uji i pashfrytëzuar i 12 pilot NPK plotësuese nga Projekti për reforma në sektorin e ujërave në nivel lokal lëviz ndërmjet 45 – 81%.
- 83% të të anketuarve të intervistuar në hulumtimin e realizuar në vitin 2014 konsiderojnë se pagimi i rregullt i faturës për sistem kanalizimi më cilësor është i arsyeshëm i cili sistem përfshin edhe pastrim të ujërave të zeza.



Të dhëna relevante për vendin

- Tarifat e ulëta, shkalla e pamjaftueshme e arkëtimit dhe obligimet e ndërmarrjeve komunale për të paguar TVSH për shërbimet e siguruar të cilat shërbime nuk janë paguar nga shfrytëzuesit, çon kah mungesa e të hyrave, që rezulton me moszbatimin e mirëmbajtjes dhe riparimeve dhe me mospasjen e mundësisë për përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës. Si rezultat i kësaj, infrastruktura ekzistuese për ujin është në gjendje të keqe.
- Në aspektin afatgjatë, sistemi i ri tarifor do e përmirësojë situatën me grumbullimin e ujërave të zeza. 92.5% të ekonomive familjare të investuara e shfrytëzojnë sistemin e njëjtë për derdhjen e ujërave të zeza nga bërja e dushit, larja dhe gatimi, dhe ujërat e zeza nga tualetët. Vetëm 6% (4% në komuna të mesme dhe 10% në komuna të mëdha) shfrytëzojnë sisteme të ndryshme për derdhje.

Udhëzimi për përparim të mëtutjeshëm - PRIORITETE KULMORE për reforma të sukseshme

- ✓ Reduktimi i ujit të pashfrytëzuar
- ✓ GIS hartimi i mjeteve (nëntokësore) dhe harmonizimi i inventarëve teknikë dhe kontabilistë
- ✓ Modernizimi i rrjetësimit të zonave dhe monitorimit operativ, menaxhimit dhe kontrollit
- ✓ Hulumtime të rregullta të kënaqësisë të konsumatorët dhe gadishmëria për të paguar
- ✓ Vendosja e kontabilitetit sipas qendrave harxhuese
- ✓ Vendosja e sistemit për kompensimin e harxhimeve për shërbimet ujore nëpërmjet zbatimit të legjislacionit të ri për tarifën e shërbimeve ujore
- ✓ ristrukturimi financiar dhe organizativ i ndërmarrjeve publike komunale të cilat sigurojnë shërbime ujore
- ✓ Sigurimi i intensifikuar i resurseve për riaftësimin e sistemeve për furnizim me ujë të pijshëm dhe sistemet e kanalizimit dhe ndërtimi i stacioneve pastruese për ujëra të zeza dhe infrastruktura e ndërlidhur me to



Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian.

Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Niras dhe partnerët e saj konsorciume dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian.



Dita botërore e ujërave 2017



Reforma në Sektorin e Ujit në Nivel Qendror

EVENTIM PËR SHËNIMIN E DITËS BOTËRORE TË UJËRAVE

22 Mars, 2017



Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian.

Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Niras dhe partnerët e saj konsorciume dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian.



H₂O



Dita botërore e ujërave, çdo vit më 22 mars, ka të bëjë me ndërmarrjen e aktiviteteve për çështjet që kanë të bëjnë me ujërat. Në vitin 2017, tema është ujërat e zeza ndërsa fushata "Pse ujëra të zeza?" ka të bëjë me zvogëlimin dhe përdorimin e sërishëm të ujërave të zeza. Qëllimi për zhvillim të qëndrueshëm 6.3 prej nesh kërkon që deri në vitin 2030, ta "përmirësojmë cilësinë e ujit nëpërmjet zvogëlimin të ndotjes, nëpërmjet eliminimit të hedhjes së mbeturinave dhe minimizimit të derdhjes së kimikateve dhe materialeve të dëmshme, me ç'rast duke e përgjysmuar proporcionalitetin e ujërave të zeza të papastruara dhe duke e rritur në masë të konsiderueshme reciklimin dhe shfrytëzimin e sërishëm të sigurt në korniza globale".



"Edhe përkaj rëndësisë së saj jashtëzakonisht të lartë, uji si sektor në përgjithësi nuk e fiton vëmendjen që e meriton. Uji është kryesori për mbijetimin e njerëzve, të ambientit jetësor dhe ekonomisë," **Ban Ki-mun, Sekretari Gjeneral i KB.**

Uji - Pse të kujdesemi?

Të dhëna nga KB

- 663 milionë njerëz akoma nuk kanë burime cilësore të ujit të pijshëm
- Deri në vitin 2050, përafërsisht deri në 70% të popullatës botërore do të jetojë nëpër qytete, krahasuar me 50% aktuale. Për momentin, më shumë qytete nëpër vendet në zhvillim nuk kanë infrastrukturë përkatëse dhe resurse për të menaxhuar në mënyrë efikase dhe qëndrueshme me ujërat e zeza.
- Në korniza globale, më shumë se 80% të ujërave të zeza që gjenerohen nga shoqëria, përsëri derdhen në ekosistemin pa u pastruar ose pa e shfrytëzuar sërish.
- 1.8 miliardë njerëz shfrytëzojnë burim uji të pijshëm të kontaminuar me fekalje, dhe për këtë arsye janë nën rrezikun të sëmuren nga kolera, nga dizenteria, tifoja dhe polio-ja. Uji i pasigurt, sanitimi dhe higjiena e papërshtatshme shkaktojnë rreth 842.000 raste vdekjeje çdo vit

"Shpeshherë, menaxhimi përkatës me ujërat konsiderohet si harxhim. Por, në realitet, e njëjta çdoherë paraqet investim të shkëlqyer... Momentalisht, në nivel vjetor, rreth 1 miliardë metër kub ujëra të zeza urbane të pastruara shfrytëzohen sërish. Por, ky vëllim paraqet më pak se 0.5% të shfrytëzimit vjetor të ujërave të ëmbla në BE. Potenciali i BE-së, kryesisht në Evropën jugore, është 6 miliardë metër kub - që është gjashtë herë më shumë se shkalla ekzistuese", **Karmenu Vella, Komisar i BE-së për ambientin jetësor, çështjet detare dhe peshkatarinë.**

Çka bën BE-ja në vend?

BE-ja e përkrah sektorin e ujërave në vend me anë të sigurimit të ndihmës për menaxhim më të mirë dhe të integruar të ujërave dhe zhvillim të infrastrukturës për pastrimin e ujërave të zeza. Në rrjedhë janë aktivitete të numërta për krijimin e mjedisit përkatës juridik dhe institucional, përpilimi i dokumentacionit teknik, punët ndërtimore, furnizimet, ndërtimi i kapaciteteve në nivel lokal dhe qendror dhe programimi i ndihmës së ardhshme. Qëllimi kryesor është të ketë ujë të pastër nëntokësor, lumej dhe liqene, të sigurohen shërbime ujore të mira për qytetarët nëpërmjet përmirësimit të grumbullimit dhe pastrimit të ujërave të zeza nëpër komunat dhe nëpërmjet zvogëlimin të ndikimit negativ mbi cilësinë e ujit, mbi natyrën dhe shëndetin.

Me ndihmën e BE-së e cila sigurohet nëpërmjet tre projekteve të cilat plotësohen dhe përkrahen në mënyrë të ndërsjellë, u vendos një sistem i ri i rregullimit ekonomik dhe i tarifave dhe sistem për çmimet e shërbimeve ujore. Dhe një sistem çmimesh, numër i madh i ndërmarrjeve komunale (29) janë të përkrahura në planifikimet e tyre shumëvjeçare për punë dhe për përshtatjen e tarifave, ristrukturimin organizativ dhe financiar dhe sigurimin e përmirësuar të shërbimeve ujore. Vazhdohet me përpilimin e Studimit nacional për ujërat dhe me Planin për investime me qëllim që ti ndihmohet vendit që të arrijë standarde evropiane për ujin. Një nga qëllimet kryesore është të mbrohet ambienti jetësor nga ndikimi negativ i ujërave të zeza urbane dhe të sigurohet ujë i sigurt për pije për të gjithë qytetarët, me çmim të kapshëm.



H₂O